



Bildungs- und Kulturdirektion
Amt für Kindergarten, Volksschule und Beratung
(Drejtoria për arsim dhe kulturë
Zyra për kopshte fëmijësh, shkollën fillore dhe këshillim)
Sulgeneckstrasse 70
3005 Bern
+41 31 633 84 51
akvb.bkd@be.ch
www.bkd.be.ch

Bildungs- und Kulturdirektion, Sulgeneckstrasse 70, 3005 Bern

Prindërve të fëmijëve/të rinjve me mbështetje të zgjeruar
(eU)

Referenca jonë: 2023.BKD.1231/1477762

Bernë, 22 prill 2024

Ndryshime në mbështetjen e zgjeruar (eU) në shkollën e rregullt.

Të dashur prindër

Që nga gushti i vitit 2024 do të ketë ndryshime në mbështetjes e zgjeruar, të cilat janë vendosur nga Drejtoria për arsim dhe kulturë e kantonit Bernë (BKD) për të gjitha shkollat e rregullta. Praktika aktuale duhet të përshtatet, kështu që do të përfitojnë më shumë fëmijë dhe shkollat mund t'i përdoren resurset në mënyrë më fleksible dhe sipas nevojës. Ndoshta, edhe për fëmijën tuaj do të ndryshojë diçka.

Aktualisht vajza juaj/djali juaj nxitet në mësim si shtesë me eU. Shkolla do të bisedojë me ju, nëse eU duhet të vazhdohet. Ndoshta, drejtoria e shkollës tashmë ju ka informuar që fëmija juaj do të mbështetet përtej viti shkollor 2023/2024. Në këtë rast, gjithçka mbetet njësoj.

Me eU do t'i përgjigjet edhe më tej nevojës për nxitje të fëmijës suaj. Përveç kësaj, shkolla mund t'i përballojë situatat sfiduese në një klasë në të ardhmen edhe më mirë. Leksione të mbështetjes së zgjeruar mund të përdoren nga drejtoria e shkollës, dhe kjo është e re, edhe për situata të vështire brenda një klase. Kjo do të thotë, se mbështetja me leksione eU mund të bëhet në mënyrë individuale, në një grup ose në të gjithë klasën.

Për leksione të mbështetjes së zgjeruar nuk nevojitet më asnjë sqarim në një këshillimore për edukim (EB). Drejtoria e shkollës e miraton këtë mbështetje.

Nëse mbështetja e zgjeruar për fëmijën tuaj duhet të zgjatet pas katër semestrave, shkolla do të bisedojë me ju. Regjistrimi i fëmijës suaj në një këshillimore për edukim është i nevojshëm që tani vetëm atëherë, nëse supozohet një nevojë nxitjeje të ndryshuar dukshëm.

Nëse ju keni pyetje të përgjithshme për mbështetjen e zgjeruar, lajmërohuni, ju lutemi, tek punonjësja kompetente të BKD-së, zonja Sabine Lütolf, sabine.luetolf@be.ch respektivisht 031 636 84 72.


Në rast të pyetjeve që lidhen konkretisht me fëmijën tuaj, ju lutemi, drejtohuni drejtpërdrejt drejtorisë kompetente të shkollës. Kjo do t'ju informojë mbi përdorimin e planifikuar të leksioneve të mbështetjes së zgjeruar.

Është një dëshirë e BKD-së dhe e shkollës që fëmija juaj të nxitet dhe përkrahet sa më mirë që të jetë e mundur.

Unë ju falënderoj nga zemra edhe për bashkëpunimin tuaj edhe më tej të mirë me shkollën në interesin e fëmijës suaj.

Përshëndetje shoqërore

Zyra për kopshte fëmijësh, shkollën fillore dhe këshillin



Erwin Sommer
Kryetar